Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", e në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2 lidhur me nenin 14, paragrafi 1, dhe 3, te Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019", e konform nenit 5, paragrafi 1, pika 1.3, lidhur me nenin 6 paragrafi 3 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenit 15 lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë ----------, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Miratohet vendimi paraprak për të zhvilluar procedurat përmes shprehjes së intersit (konkurrimit të hapur) për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri 40, (katërdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës si më poshtë;

1.1 Parcela **P-72116012-00878-117** me sipërfaqe të përgjithshme prej **S=57588m²,** sipas certifikatës së pronës **Nr. 11-463-2075/2026,** datës 02.11.2026, zona kadastrale **Grejkoc**, vendi i quajtura **"Dushkaja/Verdh"** e evidentuar në emër të P.SH.KK Suharekë, Shtepia e Kultures.

1.2 Nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen për dhënien në shfrytëzim **S=2636m²** për ushtrimin e veprimtarisë **"Zhvillimi i aktiviteteve rekreative-turistike" konform HZK-së.**

Neni 2

OBLIGOHET-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër, Drejtoria për urbanizëm dhe planifikim dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, që të zhvilloj procedurat e shprehjes së intersit, konform dispozitave të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/2019" dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S– S U H A R E K Ë

01-Nr-_____ **Kryesuesi i Kuvendit**
Më datë_____ _____
Mr.ec Bexhet KUÇI